

**Vendim nr. 321 datë 27.12.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci	Anëtar

në datën 27.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13(B) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** BELUL KOKOLLARI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 97, datë 14.04.2022 dhe nr. 141, datë 26.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 188, datë 07.06.2022 dhe nr. 250, datë 27.07.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2024-1013, datë 30.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore në datën 11.11.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat ka regjistruar një procedim penal ndaj kërkuesit Belul Kokollari, shtetas kosovar, për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal (KP), në dëm të nipit të tij të mitur.

2. Në kuadër të këtij procedimi penal, mbi kërkesën e prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 24, datë 17.11.2021, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në burg”. Pas zbatimit të masës së sigurimit dhe marrjes në pyetje të kërkuesit, ajo gjykatë ka vendosur vijimin e zbatimit të masës ndaj tij. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 25, datë 26.01.2022, ka vendosur miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

3. Në datën 28.03.2022, ndërsa vijonin hetimet paraprake, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit, me pretendimin se nuk e ka kryer veprën penale, se nevojat e sigurimit janë zbutur, pasi nuk ka më rrezik të prishë provat ndërsa ato janë marrë dhe se nuk është në gjendje të mirë shëndetësore. Me vendimin nr. 97, datë 14.04.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke e gjetur atë të pabazuar në prova dhe ligj. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 188, datë 07.06.2022, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi. Kurse për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1013, datë 30.05.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në të nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 289, pika 8, të lidhur me nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4. Kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatë edhe ndaj vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 141, datë 26.05.2022, ka vendosur rrëzimin e tij, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 250, datë 27.07.2022. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-995, datë 30.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

5. Ndërsa proceset gjyqësore si më lart vijonin, me vendimin nr. 95, datë 20.9.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat (gjyqtari i seancës paraprake) ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit. Ndërkohë, në përfundim të gjykimit në themel të çështjes, ajo gjykatë, me vendimin nr. 249, datë 11.07.2023, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose

homoseksuale me të mitur”, të parashikuar nga neni 100/1 i KP-së dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim.

6. Ndërkohë, në datën 01.07.2024 kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), ku krahas vendimeve gjyqësore të dhëna në lidhje me ankimin e tij ndaj vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit, ka kërkuar shfuqizimin edhe të vendimit nr. 97, datë 14.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për rrëzimin e kërkesës së tij për zëvendësimin e masës së sigurimit. Për këtë kërkesë, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 193, datë 23.09.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Për pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e lidhur kjo me mungesën e juridiksionit dhe të kompetencës së gjykatave shqiptare për të gjykuar veprën penale për të cilën akuzohet, parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, si dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, e lidhur me mënyrën e marrjes së provave dhe vlerën provuese të tyre, Kolegji i Gjykatës ka vërejtur se ato kanë të bëjnë me procedimin penal që është duke u zhvilluar ndaj kërkuesit dhe, si të tilla, ai i ka të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike në dispozicion që këto pretendime t`i ngrejë përpara gjykatave të zakonshme gjatë gjykimit të themelit të çështjes së tij, ndaj, për sa kohë ato nuk janë vlerësuar dhe nuk u është dhënë përgjigje nga gjykatat e zakonshme në zbatim të parimit të *subsidiaritetit*, për këto pretendime nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive, për rrjedhojë nuk mund të merren në shqyrtim. Po kështu, Kolegji i Gjykatës ka arsyetuar se është i haptazi i pabazuar kërkimi për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të gjykatave të faktit, me të cilat është rrëzuar kërkesa e kërkuesit për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, me arsyetimin se në përmbajtje të ankimit kushtetues individual kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë argument se cilat të drejta ose liri themelore i janë cenuar atij prej këtyre vendimeve gjyqësore, si dhe nuk ka ngritur asnjë argument faktik për vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin rekursi i tij nuk është pranuar.

7. Në datën 30.09.2024 kërkuesi ka paraqitur sërish ankim kushtetues individual në Gjykatë, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore me të cilat është rrëzuar kërkesa e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit (*shih paragrafin 3 të vendimit*). Ky ankim, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 28.10.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

- 8.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjykatat shqiptare nuk kanë as juridiksion dhe as kompetencë për një vepër penale që dyshohet se është kryer jashtë shtetit, në Kosovë dhe nga një shtetas i huaj, kosovar.
- 8.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë të paanshme*, pasi gjykatat, duke falsifikuar provat dhe shkelur ligjin në mbledhjen e tyre, i kanë mohuar padrejtësisht lirinë.
- 8.3. *Së drejtës për të pasur avokat*, pasi prokuroria dhe gjykata e shkallës së parë nuk ia ka garantuar këtë të drejtë të njohur nga KPP-ja dhe Direktiva nr. 2013/48/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian.
- 8.4. *Parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, pasi gjykatat e kanë paragjykuar si malësor i Kosovës, gjë e cila ka ndikuar në vendimmarrjet e tyre.
- 8.5. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat janë bazuar në prova të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Pyetja e të miturit është bërë në shkelje të nenit 58/b, shkronja “a”, të KPP-së, si dhe të nenit 50 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit e neneve 8, 98 dhe 123 të KPP-së, pasi është pyetur nga persona të së njëjtës gjini dhe pa përkthyes, dialektolog. Edhe nëna e të miturit është pyetur pa përkthyes, dialektolog, përveçse ajo gënjen në kallëzimin dhe deklaratimet e saj. Po kështu, dhe ekspertimi mjeko-ligjor i të miturit është i falsifikuar, pasi ekzaminimi mjekësor është bërë nga ekspertë të papërshtatshëm dhe në mungesë të ekzaminimeve të duhura, ndërkohë që nuk është bërë as analiza e ADN-së për t'u vërtetuar se i mituri është dhunuar dhe, nëse po, nga kush. Prokurorja nuk ka marrë komunikimet telefonike të kërkuesit dhe nuk ka pyetur babanë e të miturit. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, megjithëse në të janë ngritur pretendime për shkelje të ligjit sipas nenit 432 të KPP-së, shkelje të cilat nuk përbëjnë gjë të gjykuar, sikurse ajo ka arsyetuar.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Në rastin e ankimeve kushtetuese individuale të përsëritura, një prej kriterëve paraprake përcaktohet nga shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, sipas së cilës kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e

kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Referuar kësaj jurisprudence të Gjykatës, Kolegji verifikoi fillimisht plotësimin e kriterit paraprak të legjitimitimit *ratione temporis*, pra nëse kërkesa në shqyrtim është paraqitur brenda afatit ligjor dhe, më tej, atë *ratione materiae*, pra nëse në kërkesë parashtrohet ndonjë shkak i ri për antikushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi.

11. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji konstaton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 30.05.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues është paraqitur në datën 30.09.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se disa prej pretendimeve në kërkesën objekt shqyrtimi kërkuesi i ka parashtruar edhe në kërkesën e mëparshme, për të cilat Kolegji i Gjykatës është shprehur me vendimin nr. 193, datë 23.09.2024. Konkretisht, pretendimet që përsëriten me të njëjtat argumente janë ato për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë të paanshme, të parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, si dhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Kolegji vëren se neni 133, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 përcaktojnë se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet fillimisht fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës, ku vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur duhet të pranohet për gjykim në seancë plenare. Vendimmarrjet e kolegeve të kësaj Gjykate ose të Mbledhjes së Gjyqtarëve të dhëna në fazën e shqyrtimit paraprak të kërkesës nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as prej vetë asaj, pasi ato kanë natyrë përfundimtare (*res judicata*). Për rrjedhojë, këto pretendime të kërkuesit nuk mund të rimerren në shqyrtim.

13. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se në kërkesën në shqyrtim ngrihen disa shkaqe të reja për antikushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, konkretisht pretendimi për cenimin e së drejtës për të pasur avokat, si dhe pretendimet në lidhje me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë. Për këto të fundit, referuar argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, bazuar në parimin *iura novit curia*, duket se kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, Kolegji vëren se në kërkesën në shqyrtim, të paraqitur brenda afatit ligjor, kërkuesi ka ngritur dy shkaqe të reja për antikushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore

të kundërshtuara, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të pasur avokat*

14. Kërkuesi ka parashtruar se prokuroria dhe gjykata e shkallës së parë nuk ia kanë garantuar të drejtën për të pasur avokat, e drejtë kjo e njohur nga KPP-ja dhe Direktiva nr. 2013/48/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian.

15. Kolegji vëren se neni 31, shkronja “ç”, i Kushtetutës parashikon se gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas kur nuk ka mjete të mjaftueshme. Kjo e drejtë është materializuar në vijim edhe në nenin 34/a, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”, të KPP-së.

16. Në rastin konkret, referuar vendimeve gjyqësore bashkëlidhur kërkesës, rezulton se kërkuesi në shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga gjykata e shkallës së parë është mbrojtur nga një avokat i zgjedhur prej tij, i cili e ka mbrojtur atë edhe në gjykatën e apelit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për *cenimin e së drejtës për të pasur avokat* është haptazi i pabazuar.

*C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*

17. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, megjithëse në të janë ngritur pretendime për shkelje të ligjit sipas nenit 432 të KPP-së, shkelje të cilat nuk përbëjnë gjë të gjykuar, sikurse ajo ka arsyetuar.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse mohohet e drejta e aksesit, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, para së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 16, datë 23.03.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjithashtu, sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 10, datë*

04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 1, datë 19.01.2018; nr.25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata është shprehur se në rast se Kolegji i asaj gjykate në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që u jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 59, datë 23.07.2015; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Po kështu, Gjykata, në mënyrë konstante, ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Bazuar në standardet kushtetuese të mësipërme, Kolegji do të verifikojë nëse janë ose jo haptazi të pabazuara, referuar materialeve të çështjes, pretendimet e kërkuesit se nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë për shkaqet e ngritura në rekurs, se arsyetimi i vendimit prej saj është i pamjaftueshëm, si dhe se interpretimi nga ajo i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës.

22. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë është vënë në lëvizje nga kërkuesi përmes një kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të caktuara më herët në kuadër të procedimit penal që po zhvillohet kundër tij. Gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit dhe në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar se ndaj tij vijon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 100 i KP-së, sikundër edhe rreziku i largimit referuar marzhit të dënimit që ligji parashikon për atë

vepër penale, si dhe se në gjendjen aktuale të procedimit penal masa e zbatuar vijon të jetë në përshtatje me nevojat e sigurimit, ndërsa nuk provohet që ato të jenë zbutur dhe që masa të mos i përgjigjet rëndësisë së faktit apo dënimit që mund të caktohet. Përfundimet e gjykatës së shkallës së parë janë gjetur të drejta nga gjykata e apelit, e cila pas ankimit të kërkuarit ka lënë në fuqi vendimin e saj.

23. Ndërkohë për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 289, pika 8, të lidhur me nenin 432 të KPP-së. Sipas asaj gjykate, në vendimmarrjen e gjykatës së apelit nuk konstatohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit material ose procedural me rëndësi për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore apo me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave dhe as që vendimi i saj të vijë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas atij kolegji, gjykatat e faktit, me të drejtë, kanë arritur në përfundimin se nuk janë kushtet për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuarit, ndërsa referuar nenit 260 të KPP-së nuk rezulton që në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe të shqyrtimit të saj nga gjykatat e faktit të ketë ndryshuar rëndësia e faktit apo të ketë ndonjë ndryshim të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën ai po hetohet, përkundrazi, ndaj tij vijon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i KP-së, përveçse edhe nevojat e sigurimit nuk kanë ndryshuar apo janë zbutur krahasimisht me momentin kur ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal. Ndryshimi i masës, arsyeton Kolegji Penal, përlligjet vetëm me ndodhjen e fakteve të reja, por se në rastin konkret nuk është evidentuar asnjë fakt i ri, ndërkohë që pretendimet e kërkuarit nuk përbëjnë shkak për zëvendësimin e masës, pasi nuk përbëjnë rrethanë të re, në kuptim të nenit 260, pika 2, të KPP-së. Kolegji Penal ka evidentuar se referuar vendimit unifikues penal nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi që cakton masën e sigurisë, pasi merr formë të prerë, përbën gjë të gjykuar, që do të thotë se nuk lejohet zëvendësimi i saj nëse ekzistojnë po ato rrethanat të faktit dhe ligjit që kanë ekzistuar në çastin e dhënies së vendimit për caktimin e masës. Për pretendimet e ngritura në rekurs në lidhje me çmuarjen e provave dhe parimin e prezumimit të pafajësisë, Kolegji Penal ka vlerësuar se ato kanë të bëjnë me kryerjen ose jo të veprës penale prej të hetuarit dhe, si të tilla, nuk i përkasin kësaj faze, por gjykimin në themel të çështjes. Sipas tij, referuar provave të mbledhura deri në këtë moment, por edhe pretendimeve të kërkuarit, nuk rezulton të ketë dalë ndonjë fakt, rrethanë apo provë, që mund të vlerësohet në favor të zbehjes/minimizimit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në provat ekzistuese që në momentin e caktimit të kësaj mase.

24. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se duke iu referuar pretendimeve të kërkuarit, fakteve në rastin konkret dhe standardeve kushtetuese, rezulton se ai ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e zakonshme në lidhje me pretendimet e ngritura në kërkesë, në ankim, sikundër edhe në rekurs. Vendimet e gjykatave të faktit pasqyrojnë mjaftueshëm faktet dhe ligjin e zbatueshëm për sa u përket kushteve për zëvendësimin e masave të sigurimit personal, sikundër edhe argumentet e gjykatave në lidhje me qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Po kështu, Gjykata e Lartë, në rolin e saj si gjykatë e ligjit, i ka dhënë përgjigje kërkuarit në lidhje me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit procedural, të aplikueshëm në rastin e tij. Në këndvështrim të standardit të arsytimit, Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit të paraqitur nga kërkuari, ka arsyetuar se përse nuk bëjnë pjesë në ato të parashikuara nga neni 289, pika 8, të lidhur me nenin 432 të KPP-së, duke e vlerësuar të drejtë vendimmartjen dhe arsytimin e gjykatës së apelit. Mospranimi i rekursit të kërkuarit nga ana e atij kolegji të Gjykatës së Lartë, në kuadër të shqyrtimit paraprak të tij, është në përputhje me kompetencat e njohura nga ligji procedural, ndërsa është në vlerësimin e atij kolegji për të vendosur nëse çështja duhet të shqyrtohet në seancë dhe, për më tepër, për të njësuar praktikën gjyqësore. Në procesin gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuari nuk konstatohen shkelje të të drejtave kushtetuese dhe as që zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme të ketë qenë arbitrar, pra që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës. Vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor kërkesa e kërkuarit nuk është pranuar, nuk vë në dyshim të drejtën e tij për proces të rregullt.

25. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor nuk gjen mbështetje në materialet e çështjes, ndaj ky pretendim është haptazi i pabazuar.

26. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “dh” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.